REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.8367prot. Himarë, më 05.11.2026

VENDIM

Nr.61, Datë 30.10.2026

PËR

"NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.55, DATË 31.10.2025, TË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË, "PËR MIRATIMIN E VENDIT TË DEPOZITIMIT DHE SISTEMIMIN E MBETJEVE TË NGURTA, NË ZONËN E VISHËS"

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", *i përditësuar*, ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", ligjin Nr.8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave", ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i përditësuar , ligjin nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i përditësuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", ligjin nr.89/2022 "Për policinë Bashkiake", VKM nr.452, datë 26.07.2023 "Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake", VKM nr.575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte", VKM nr.660, datë 31.10.2018 "Për miratimin e kerkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve", VKM nr.608, datë 17.9.2014 "Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", i ndryshuar, VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr.866, datë 04.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre", VKM nr.652 datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura", ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" si dhe VKB Himarë Nr.8 datë 20.08.2019 "Mbi miratimin e planit bashkiak të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për Bashkinë Himarë si dhe miratimin e vënies në dispozicion të hapësirës të stabilizimit dhe kompostimit pranë stacionit të transferimit të mbetjeve në Vumlo". Nisur nga relacioni i Drejtorisë Juridike, me propozimin e

Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 30.10.2026, miratoi me 13 (trembëdhjetë) vota pro, 3 (tre) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë;

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 55, datë 31.10.2025, të Këshillit Bashkiak Himarë, termi "Venddepozitim i mbetjeve të ngurta" ndryshohet dhe zëvendësohet me termin "Vendstacionim i përkohshëm i mbetjeve të ngurta".
2. Në titullin e vendimit nr. 55, datë 31.10.2025, togfjalëshi "Për miratimin e vendit të depozitimit dhe sistemimin e mbetjeve të ngurta, në zonën e Vishës" zëvendësohet me togfjalëshin: "Për miratimin e vendstacionimit të përkohshëm dhe sistemimin e mbetjeve të ngurta, në zonën e Vishës".
3. Në të gjitha dispozitat, përcaktimet dhe referencat e vendimit nr. 55, datë 31.10.2025, ku përdoret termi "venddepozitim", ai do të lexohet dhe interpretohet si "vendstacionim i përkohshëm i mbetjeve të ngurta".
4. Ky ndryshim bëhet me qëllim saktësimin e funksionit dhe karakterit të hapësirës së miratuar në zonën e Vishës, si një vendstacionim i përkohshëm për mbetjet e ngurta, dhe jo si venddepozitim përfundimtar i tyre.
5. Të gjitha përcaktimet e tjera të vendimit nr. 55, datë 31.10.2025, të cilat nuk ndryshohen nëpërmjet këtij vendimi, mbeten në fuqi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Himarë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË